



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINE**

---

Numri i lëndës: 2023:193970

Datë: 04.01.2024

Numri i dokumentit: 05152233

CPC.nr.1210/23

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtari Ibrahim Maloku, në çështjen juridike përmbartimore ndërmjet kreditores S.Z nga Prishtina, e përfaqësuar në bazë të autorizimit nga Sylejman Klinaku, avokat në Prishtinë, ndaj debitorit Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK) – Qendra Klinike Universitare e Kosovës, me seli në Prishtinë, lidhur me çështjen përmbartimore përmbushje e borxhit, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori, kundër aktvendimit mbi lejimin e përmbartimit CPC.nr.1210/23, të datës 15.11.2023, jashtë seancës gjyqësore, me datë 04.01.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

REFUZOHET i pa bazuar prapësimi i debitorit Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK) – Qendra Klinike Universitare e Kosovës, me seli në Prishtinë, ndërsa mbetet në fuqi aktvendimi mbi caktimin e përmbartimit Cpc.nr.1210/23, i datës 15.11.2023.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të përfaqësuesit të autorizuar të kreditores të datës 13.06.2023, përmes aktvendimit Cpc.nr.1210/23, të datës 15.11.2023 ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit përmbartues – Vendimit të Inspektoratit të Punës në Prishtinë 01 Nr.21-1715/94, i datës 10.02.2020; Vendimit nr.303/2020, të datës 19.05.2020 si dhe Vendimit për Korrigjimin e Gabimeve Nr.01/21-1178, të datës 18.11.2020, përmes të cilit është detyruar debitorin që në afat prej 7 ditësh t'i paguajë kreditores shumën prej 507.23 €.

Kundër këtij aktvendimi, prapësim ka paraqitur debitori brenda afateve të përcaktuara ligjore. Në prapësimin e ushtruar theksohet se propozimi për përmbartim është paraqitur në kundërshtim me nenet 21, 24, 27 dhe 36 të LPP-së, nenin 50 të Ligjit të Procedurës Administrative dhe nenit 162 par.2 dhe 3 dhe 391 pika d) të LPK-së, pasi që Vendimi 01 Nr.21-1715/94, i datës 10.02.2020, sipas të cilit është inicuar propozimi për përmbartim nuk i

përmbushë kushtet konform LPP-së, ndërsa vendimi korrigjues me nr.01/21-1178, i dt.18.11.2020 nuk mund të pranohet si titull përmbarues pasi është në kundërshtim me Ligjin për Procedurën Administrative. Tutje në prapësim theksohet se për të njëjtën çështje, kreditorja ka paraqitur propozim për përmbarim P.nr.707/20, me dt.28.05.2020 ndaj debitorit në bazë të vendimit të njëjtë dhe Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin PPP.nr.1271/20, të datës 07.03.2022 e ka pranuar prapësimin e debitorit dhe e ka shfuqizuar urdhërin për përmbarim, e po ashtu Gjykata e Apelit e Kosovës, lidhur me këtë çështje me aktvendimin AC.nr.3688/22, e ka refuzuar ankesën e kreditores. Përveç kësaj, pretendohet se propozimi për përmbarim i kreditores është i pasafatshëm, duke iu referuar edhe Mendimit Juridik për Shpërblimin Jubilar nr.40/23, të dt.27.02.2023 të Gjykatës Supreme të Kosovës, pasi propozimi është paraqitur pas skadimit të afatit të zbatueshmërisë të Kontratës Kolektive Sektoriale. Mbi bazën e këtyre pretendimeve, ka propozuar që të aprovohet si i bazuar prapësimi, ndërsa aktvendimi i goditur të anulohet, pasi që kemi të bëjmë me çështje të gjykuar (res iudicata).

Përgjigje në prapësimin e ushtruar nga debitori ka paraqitur përfaqësuesi i autorizuar i kreditores. Në përgjegjen e parashtruar ndër tjera pretendohet se përmbajtja e kundërshtimit të debitorit nuk përmbushë asnjërin nga kushtet e parapara me LPP, e po ashtu e vlerëson si të pa bazuar pretendimin se propozimi për përmbarim është i pasafatshëm, për faktin se konform Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme, kërkesat e tilla parashkruhen për afatin 3 vjeçar. Pretendimin e debitorit se kemi të bëjmë me çështje të gjykuar, pala kreditorë po ashtu e konsideron të pa bazuar, për faktin se edhe Gjykata e Apelit në arsyetimin e aktvendimit Ac.nr.858/21, të dt.17.05.2022 ka theksuar se *“pala kreditorë eventualisht mund të parashtrorj propozim të ri në bazë të vendimit i cili i plotëson kushtet për tu konsideruar dokument i rregullt përmbarimor, pasi që në këtë procedurë ka bërë lëshime të cilat e kanë pamundësuar përmbarimin e propozuar”*. Më tutje pretendohet se debitori nuk ka paraqitur asnjë dëshmi që i ka përmbushur obligimet ndaj kreditores, e po ashtu nuk ka paraqitur asnjë provë lidhur me pretendimet e paraqitura në prapësim, siç kërkohet me nenin 69 par.4 të LPP-së. Mbi bazën e këtyre pretendimeve, ka propozuar që të refuzohet si i pa bazuar prapësimi i debitorit, ndërsa aktvendimi mbi lejimin e përmbarimit të mbetet në fuqi.

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, pretendimeve të përfaqësuesit të autorizuar të kreditores të paraqitura në përgjigje në prapësim si dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se prapësimi është i pa bazuar, për arsye në vijim:

Dispozita nga neni 22 par.1, pika 1.2 e LPP-së, e cila përcakton llojet e dokumenteve përmbaruese, parasheh që: *“Dokumente përmbaruese janë: vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi (më tej: ujdia)”*. Tutje, dispozita nga neni 24 par.3 e LPP-së parasheh që: *“Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbarimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë”*. Në anën tjetër, neni 27 par.1 i LPP-së përcakton elementet që duhet t'i përmbajë një dokument përmbarimor në mënyrë që të jetë i përshtatshëm për përmbarim. Kjo dispozitë parasheh që *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*. Referuar mënyrës se si është formuluar, rrjedh se dispozita në fjalë kërkon që elementet e

renditura më sipër duhet të përmbushen në mënyrë kumulative, në mënyrë që dokumentit mbi bazën e të cilit është lejuar përmbartimi t'i njihet cilësia e dokumentit të përshtatshëm për përmbartim.

Në rastin konkret, përmbartimi është lejuar në bazë të Vendimit të Inspektoratit të Punës në Prishtinë 01 Nr.21-1715/94, i datës 10.02.2020; Vendimit nr.303/2020, të datës 19.05.2020 si dhe Vendimit për Korrigjimin e Gabimeve Nr.01/21-1178, të datës 18.11.2020. Nga vlerësimi i këtij dokumenti, Gjykata gjen se i njëjti paraqet vendim të dhënë në procedurë administrative, si dhe përmban të dhëna për kreditorin, debitorin, objektin, mjetet, shumën dhe kohën e përmbushjes së detyrimit dhe si i tillë i përmbushë të gjitha kriteret ligjore të përcaktuara nga nenet 22, 24 dhe 27 të LPP-së për tu konsideruar i përshtatshëm për përmbartim, në kuptim të dispozitës nga neni 21 të LPP-së, e cila parasheh që: *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*.

Me rastin e vendosjes, Gjykata mori parasysh pretendimet e ngritura nga pala debitore në prapësim. fillimisht në faktin se kemi të bëjmë me çështje të gjykuar, mbi bazën e argumentit se për të njëjtën çështje, kreditorja ka paraqitur propozim për përmbartim P.nr.707/20, me dt.28.05.2020 ndaj debitorit në bazë të vendimit të njëjtë dhe Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin PPP.nr.1271/20, të datës 07.03.2022 e ka pranuar prapësimin e debitorit dhe e ka shfuqizuar urdhërin për përmbartim, e po ashtu Gjykata e Apelit e Kosovës, lidhur me këtë çështje me aktvendimin Ac.nr.3688/22, të dt.06.04.2023 e ka refuzuar ankesën e kreditores. Pretendimi tjetër konsiston në faktin se propozimi për përmbartim i kreditores është i pasafatshëm, mbi bazën e argumentit se i njëjti është paraqitur pas skadimit të afatit të zbatueshmërisë të Kontratës Kolektive Sektoriale.

Lidhur me pretendimin që kemi të bëjmë me çështje të gjykuar, Gjykata konstatoi se në rastin të cilit i referohet debitori në prapësim, përmbartimi është lejuar duke u mbështetur në Vendimin e Inspektoratit të Punës në Prishtinë 01 Nr.21-1715/94, të datës 10.02.2020, i cili është vlerësuar se nuk i përmbushë kriteret e kërkuara për tu konsideruar i përshtatshëm për përmbartim dhe si rrjedhojë urdhëri përmbartimor është shfuqizuar. Në anën tjetër, objekt i propozimit për përmbartim në këtë çështje është edhe Vendimi për Korrigjimin e Gabimeve Nr.01/21-1178, i datës 18.11.2020, i cili mbi bazën e arsyeve të lartëcekura e ka cilësinë e dokumentit të përshtatshëm për përmbartim. Në këtë kuptim, përderisa ekziston dallimi i evidentuar sa i përket dokumentit mbi bazën e të cilit është propozuar, respektivisht është lejuar përmbartimi, nuk mund të themi se kemi të bëjmë me çështje të gjykuar (res iudicata).

Pretendimin se propozimi për përmbartim është paraqitur pas skadimit të afatit të zbatueshmërisë së Kontratës Kolektive Sektoriale, Gjykata po ashtu e konsideron pa ndikim në vendosjen e kësaj çështje. Gjykata vë në dukje faktin se procedura përmbartimore udhëhiqet nga parimi i rigorozitetit formal, që nënkupton se objekt vlerësimi është vetëm përshtatshmëria e dokumentit mbi bazën e të cilit është lejuar përmbartimi, në kuptim të vlerësimit të përmbushjes së tipareve të cilat kërkohen me ligj për tu trajtuar si i tillë.

Bazuar në një vlerësim të tillë, Gjykata pretendimet e parashtrura nga ana e debitorit i vlerëson si të pa themelta dhe rrjedhimisht pa ndikim në një vendosje ndryshe, e cila do të rezultonte me aprovimin e prapësimit dhe anulimin e aktvendimit mbi caktimin e përmbarimit. Mbi këtë bazë, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke e refuzuar prapësimin e debitorit dhe duke e lënë në fuqi aktvendimin e goditur me prapësim.

Mbi bazën e arsyeve të lartëcekura, në kuptim të dispozitës nga neni 73 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË  
- Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil -  
CPC.nr.1210/23, datë 04.01.2024

Gjyqtari,  
Ibrahim Maloku

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimin të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.